

## 1 INFORMACION MBI KËRKUESIN/OPERATORIN

### 1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Emri i Kompanisë	<b>Spitali Kolonje</b>
Statusi Ligjor	Ent publik
Ortaket/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)	
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	
Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mësipërme	
Numri i rregjistrimit të Kompanisë(NIPT)	<b>K 97711091 T</b>
Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit")	12.2 Spitalet.....
Kodi SNAP <sup>1</sup>	
Kodi NOSE-P <sup>2</sup>	
Numri i Punonjësve	20
Përfaqësuesi i autorizuar	1
Emri dhe Mbiemri	
Pozicioni në Kompani	Drejtore
Telefoni	
Faksi	
E-mail	

### 1.2 INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN

Emri i instalimit/impiantit <sup>3</sup>	Spitali Kolonje
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianti	Rruga Dhori Qirjazi, Qyteti Erseke
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	X = 44 67 072, 29 Y = 44 72 911.06

<sup>1</sup> Nomenklatura e zgjedhur për burimet e ndotjes së ajrit, të specifikuara në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

<sup>2</sup> Nomenklatura për burimet e shkarkimit, të specifikuara në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

<sup>3</sup> Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedis <sup>1</sup>	12.2 Spitalet.....
Kapaciteti i projektuar	Ju sherben rreth 24 000 banoreve te Bashkise se re te Kolonjes

Tabela në vijim përfshin listën e të gjithë lejeve, liçensave, autorizimeve të përfshira në datën e dorëzimit të Formularit të kérkesës.

Leja, Liçensa, Autorizimi	Nr. Ref.	Data e Lëshimit	Periudha e vlefshmërisë

Duhet të përfshihen të gjitha lejet, liçensat, autorizimet e vlefshme në datën e dorëzimit të kérkesës.

### **1.3. INFORMACIONI MBI PERSONIN E KONTAKTIT TË AUTORIZUAR NGA ADMINISTRATORI NË LIDHJE ME LEJEN**

Emri dhe Mbiemri	
Adresa	
Pozicioni në kompani	
Telefoni	
Faksi	
E-mail	

---

<sup>1</sup> Shkruani kodet e specifikuara në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuara në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

## 1.4. PRONËSIA E TOKËS

Emri/adresa e pronarit/pronarëve të tokës, Numri i identifikimit të pronës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP<sup>5</sup> ku janë ndërmarrë (nqse ndryshojnë nga ato të kërkuesit) apo do të ndërmerrën aktivitetet (nqse ndryshojnë nga ato të kërkuesit)

<b>Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve</b>	<b>Ent Publik - Spitali Kolonje</b>
Të dhëna për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP	<b>Pronesi shtet</b>
Adresa	Rruga Dhori Qirjazi, qyteti Erseke
Informacion për kontratën e qerasë nëse ka Nr. i kontratës së qerasë nëse kërkuesi nuk është pronar i tokës deri në këtë moment	

## 1.5. PRONËSIA E IMPLANTIT

Emri dhe adresa e pronarit të impiantit ku kryhet aktiviteti, si dhe informacion mbi kontratën e qerasë nëqoftëse kërkuesi nuk është pronari i impiantit.

<b>Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve</b>	<b>Ent Publik - Spitali Kolonje</b>
Adresa	Rruga Dhori Qirjazi, qyteti Erseke
Informacion mbi kontratën (qeradhënësi dhe qeramarrësi, afati i kontratës, mënyrat e përfundimit të kontratës; periudha e vlefshmërisë) Bashkëngjisni një kopje të kontratës së qerasë	Kontrate me subjektin MEDI - TEL shpk Tirane me date 11.04.2016 per transferimin e mbetjeve te rrezikshme te spitalit Kolonje.

---

<sup>5</sup> Zyra e Regjistrimit te pasurive te paluajtshme

## 1.6. APLIKIMI I BËRË PËR:<sup>6</sup>

Shënoni ✓ në kutinë përkatëse

- Impiente dhe instalime të reja
  - ✓ **Impiente dhe instalime ekzistuese**
- Ndryshim i konsiderueshëm në impiantet dhe/ose instalimet ekzistuese
- Ndërprerje të aktiviteteve

## ANEKSI 1

Nuk ka impiant te ri, megjithese per efekt kumulativ mjedisor po paraqesim një plan zhvillimi te zones bashkengitur dokumentave te aplikimit per Leje Mjedisi tipi B.

### Imazh satelitor – Vendndodhja e spitalit ne qytetin e Ersekës



<sup>6</sup> Kjo kërkesë nuk i referohet transferimit të lejes në rast të ndryshimit të pronësisë

#### 1.7 INFORMACION INFORMACION NË LIDHJE ME NDRYSHIME TË KONSIDERUESHME TE PROPOZUARA TE LEJES SË TIPIT B PER NJE INSTALIM/IMPIANT EKZISTUES

Operatori/kérkuesi plotëson tabelën e mëposhtme vetëm kur kérkon ndryshime të kushteve të lejes së mjedisit të Tipit B, për një instalim/impiant ekzistues.

Emri i impiantit (sipas lejes ekzistuese të mjedisit)	
Data e dorëzimit të kërkesës për ndryshime të lejes së lëshuar të mjedisit të Tipit B	
Data dhe numri i lejes ekzistuese të mjedisit, të Tipit B, (refero <b>Nr.e identifikimit të Lejes sipas Regjistrat të AKM</b> )	
Vendodhja e impiantit/ instalimit (qarku/ bashkia/komuna, numri kadastral)	
Arsyeja/arsyet për ndryshimin e kérkuar në lejen e mjedisit	

## **II. PËRSHKRIMI I INSTALIMIT, NJËSITË E TIJ TEKNIKE DHE AKTIVITETET /VEPRIMTARITË E LIDHURA DREJTPËRDREJT ME TË**

**Menaxhimi i mbetjeve spitalore** eshte nje detyre profesionale e ligjore e operatoreve te fushes se mjekesise, te cilet kontraktohen nga administrata spitalore. Trajtimi i ketyre mbetjeve behet per te eleminuar potencialin patogjen qe keto mbetje permabajne, ne menyre qe te shmanget infektimi i ambientit, toksiciteti kimik dhe radioaktiv dhe ndotja e pakontrolluar e mjedisit dhe shendetit te njerezve. Grumbullimi, transporti dhe asjesimi ne menyre te sigurte i mbetjeve spitalore eshte detyre me rendesi e te gjithe operatoreve te kesaj fushe.

Rreth 20 % e mbetjeve spitalore jane te kategorizuara si mbetje te rrezikshme dhe ne momentin qe keto mbetje jane ne kontakt me objekte te tjera, edhe keto objekte konsiderohen po njesoj. Rrjedhimisht ne realitetin shqiptar, ne momentin kur jemi deshmidtare te faktit qe mbetjet spitalore perfundojne ne koshat e mbetjeve urbane, kuqtojme se te flasim vetem per menaxhim te ketyre te fundit, devijojme nga realiteti dhe detyrimisht e trajtojme ate ne menyre te fragmentuar.

### **Menaxhimi i mbetjeve**

Menaxhimi ne menyre te pershatshme i ketyre mbetjeve eshte nje sherbim i rendesishem per spitalin. Pergjegysi i sherbimeve te mjedisit ne spital perditson rregulloren e spitalit ne lidhje me menaxhimin e mbetjeve, qe eshte ne perputhje me rregulloret e Ministrise se Shendetesise dhe me VKM Nr.798, datë 29.9.2010 per miratimin e rregulores "PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE".

Pergjegysi i sherbimeve te mjedisit ne spital duhet te kete njohani te sakta lidhur me volumin dhe llojin e mbetjeve qe krijoen ne spital per cdo pacient dhe per cdo pavion, gjithashtu mbikqyr procedurat per grumbullimin e mbetjeve te ndara, vec ato te rrezikshme e vec ato te parrezikesme, dhe eleminimin e tyre ne perputhje me vecorite e tyre.

### **Mbetjet spitalore**

Mbetje spitalore quhen ato te cilat mund te mbartin mikrobe, viruse apo parazite, nepermjet te cilave mund te perhapet infeksioni midis njerezve. Te tilla mund te jene gjaku, urina, sekrecionet, tubat e aspirimit, drenazhit, apo inde qe hiqen nga te semuret etj. Nje kategori me rrezik i mbetjeve ne spital jane mjetet shpuese apo prerese si age, bisturi, qelq, llamarine etj. Prandaj spitali parashikon parandalimin e rrezikut qe mbartin keto mbetje, nepermjet iniciativa per mbrojtjen nga infeksionet spitalore dhe nga incidentet.

Ne kendveshtrimin mjedor duhet te jemi te vemenshem ne vend grumbullimin e tyre zinxhir nga infermieria apo salla e operacionit deri ne terheqjen e ketyre mbetjeve nga spitali. Ne cdo momente te ketij zinxhiri transportues, duhet evituar kontakti i tyre me personelin, te semuret apo vizitoret.

### **Mbetjet e rrezikshme spitalore**

Mbetjet e rrezikesme perfshijne kategorite e me poshtme:

- Mbetjet e mprehta
- Mbetjet laboratorike dhe mbetjet e lidhura me to (mbetje farmaceutike, mbetje kimike, etj.)
- Indet njerezore, duke perfshire materialet ose solucionet qe permabajne gjak, mbetje qelbi etj.
- Mbetje te kontaminuara me likide apo lengje trupore, te cilet jane faktore kryesore ne perhapjen e infeksioneve.

Te gjitha mbetjet e rrezikshme spitalore mblidhen ne kosha te vecante te percaktuar dhe te dallueshem nga koshat e mbetjeve jo te rrezikshme. Keto kosha jane zakonisht me ngjyre te verdhe dhe te pajisur me qese te trasha te posacme per mbetje te rrezikshme.

Ne kohen e caktuar per tu zbruzur koshat, ndiqet kjo procedure: hiqet qesja, mbylllet, lidhet mire dhe futet ne kuti kartoni te posacme, e cila mbylllet dhe etiketohet me emrin e pavionit nga ku mblidhen keto mbetje. Pasi mbylllet dhe etiketohet kutia, transportohet per ne qendren e grumbullimit.

Qe nga aty mbetjet merren te pakten nje here ne dy jave nga subjekti i kontraktuar "MEDI - TEL" shpk Tirane nga administrata e spitalit per asgjesimin e tyre. Mbushja maksimale me mbetje e nje koshi konsiderohet kur volumi i mbetjeve arrin dy te tretat e kapacitetit qe ka dhe ky eshte nje faktor vleresimi per punonjesin e sherbimit te mjedisit per te zbruzur koshin pas zbrizjes apo largimit te koshit, gjithmone behet zvendasimi i qeses apo koshit si dhe pastrimi i vendit rreth koshit.

Mbetjet spitalore prodhohen nga shume subjekte mjekesore, te cilat prodhojne edhe mbetje te rrezikshme. Trajnim i ketyre mbetjeve ne respektimin e mjedisit eshtë një detyre profesionale dhe ligjore e operatoreve te fushes se mjeksise. Ky trajtim duhet te eliminoje potencialin patogjen qe keto mbetje permajnë, ne menyrë qe te shmanget infektimi i ambientit, toksiciteti kimik dhe radioaktiv dhe ndotja e pa kontrolluar e mjedisit. Trajtimi dhe transportimi ne menyrë te sigurt eshte detyra e te gjithe operatoreve te fushës.

Mbetjet spitalore janë një rezervuar i mundshëm për zhvillimin e mikroorganizave patogjene dhe kërkojnë trajtimin e duhur, te sigurt dhe te besueshëm. Rreziku kryesor lidhur me përhapjen e infeksionit eshtë depërtimi i kontaminuar i gjakut. Një age, një shiringe, instrumentet kirurgjikale, mbetjet e nderhyrjeve kirurgjikale, te gjitha sendet mjeksore te vena ne kontakt me trupin e te semurit, nga ku mund te percohet infekzioni, pajisjet laboratorike te vena ne kontakt me lengjet ose indet humane, shiringat dhe te gjitha sendet e perdonura ne laborator per manipulin e permajtjes se ketyre kampioneve humane.

Gjate magazinimit te mbetjeve mjeksore nga subjekti i kontraktuar Medi – Tel duhet te kihet parasysh:

- Te magazinohen ne kontenitoret perkates te mbetjeve,
- Sipas rregullores se OBSH per magazinimin, kontenitoret te vendosen ne ambiente te myllura dhe te sigurta.
- Te sigurohet dizinfektimi i mire i ambientit ne rastin e kontaminimit aksidental te tij.
- Te trajtohen mbetjet qe janë vene ne kontakt me mbetjet mjeksore si mbetje te rrezikshme.

### Kategorite e mbeturinave mjeksore

Mbeturina mjeksore mund te perkuftohet si mbeturine e gjeneruar si rezultat i diagnostikimit, trajtimit, dhe imunizimit te njerëzve. Mbeturinat grupohen ne kategorite e meposhtme:

Mbeturina Mjekësore Specifike te Sistemuara.

Kjo kategori mbeturinash përfshin mbeturinën patologjike. Keto mbeturina perbehen kryesisht nga ndarjet me poshtë:

1. Kulturat biologjike dhe mbetjet e tyre, dhe stoqe te substancave te infektuara dhe perberesit biologjik te tyre

2. Mbetje anatomike të indeve trupore, si organe pjese të trupit duke perfshire lengje të indeve të marra gjate nderhyrjeve të ndryshme kirurgjikale, autopsive ose procedurave mjekesore.
3. Gjak human dhe produktet e tij, materiale te kontaminuara me gjakun human të mprehtat si: shiringa, piepta, lama te mprehta, vegla dhe age, qelq i thyer dhe i pathyer
4. Materiale të izolimit të semundjeve i kontaminuar me gjak, sekrecione, eskrecione etj, nga humane të izoluar nga humane të tjere për të ndaluar perhapjen e semundjeve;
5. Paisjet mjekesore të kontaminuara të ndodhura në kontakt me material të infektuara;
6. Mbetjet laboratorike në kontakt me material biologjik.

#### **Perberja e mbetjeve infektive ndahet si me poshte**

• mbeturina speciale e ngurtë -	56.4%
• mbeturina mjekësore -	17.5%
• karton ambalazhues –	10.9 %
• mbeturinat e pacientëve -	8.5 %
• letra -	3.1 %
• mbeturina të rrezikshme -	2.0 %
• paleta druri -	0.4 %
• bateritë “dry cell” -	0.4 %
• grafi me rreze x -	0.3 %
• të tjera -	0.4 %.

#### **Mbeturina të rrezikshme**

Sipas OBSh-së, mbeturina konsiderohet e rrezikshme, nëse përban një ose më shumë përbërës të pëcaktuar me ligj, nëse shfaq një ose disa nga katër karakteristikat (toksike, radioaktive, eksplozive, gërryese). Mbeturina radioaktive e nivilit të ulët është mbeturinë, që shfaq karakteristika të tillë radiologjike si rrezatim/[shpërbërje](#)/[zbërthim](#)/ shkatërrim/[kalbje](#) radioaktive.

Lloje të ndryshme të mbeturinave të rrezikshme janë gjeneruar në objektet e spitalit. Ksileni, metanol, dhe acetoni janë tretësit e përdorur më shpesh. Kimikate të tjera të përfshira janë tolueni, kloroformi, klori metileni, trikloroetileni, etanol, izopropanoli, acetat etileni, dhe acetonitrili. Mbeturinat formaldehid (solucione formalinë) janë gjetur në patologji, autopsi, dializë, infermieri, dhomën e urgjencës, kirurgji, e të tjera. Mbeturinat kimioterapike (p.sh., Chlorambucil, Cytosine, Daunomycin,etj), llogariten si mbeturina të rrezikshme, që zënë një volumetri të madhe në disa spitale.

Magazinimi, transportimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme duhet te behet sipas dispozitave ne fuqi dhe ne zbatim te kontrates te lidhur me subjektin MEDI - Tel shpk Tirane.

### **Mbeturina radioaktive e nivelit të ulët**

Materialet radioaktive përdoren gjatë diagnostikës dhe trajtimit, si dhe në hulumtime shkencore e studimore. Radionuklidët e përdorur në mjekësinë bërthamore, laboratorët e klinikave, dhe laboratorët kërkimor kanë jetëgjatësi, që varion nga disa orë në disa mijëra vjet. Metodat e asnjësimit përfshijnë magazinimin për shpërbërje apo "shpërbërje në magazinë") dhe transportin e mbeturinave radioaktive në një territor të autorizuar për depozitim përfundimtar.

Radionuklidët me jetëgjatësi të shkurtër zakonisht ruhen në një njësi të sigurt për një kohë të mjaftueshme për tu shpërbërë sipas niveleve të shkallëzuara (siç konfirmohet nga një sondazh i rrezatimit) dhe më pas për tu asnjësuar. Reduktimi i vendburimit mund të realizohet duke kufizuar sasisë e akumuluar të radioaktivitetit, duke përdorur materiale jo-radioaktive apo radionuklidë jetëshkurtër, atje ku është e mundur, dhe duke projektuar procedura laboratorike për të reduktuar volumin e mbeturinave të përzier.

**Tabela e ndarjes se mbeturinave**

KATEGORIA E MBETURINËS	PËRSHKRIMI
<b>Kulturat dhe Stoqet</b>	Kulturat dhe stoqet e substancave infektive dhe materialeve biologjike të lidhura me to.
<b>Mbeturina Anatomike (ose Mbeturinat Patologjikale Organike)</b>	Inde, organe dhe pjesë të trupit, duke përfshirë këtu dhe lëngje të trupit të derdhur gjatë operimit, autopsisë, ose procedurave të tjera mjekësore
<b>Gjaku Organik, Produktet e Gjakut, dhe Fluidë të Tjerë Trupor</b>	Gjak organik të papërdorshëm, komponentët ose produktet e gjakut; sende të prekura nga gjaku, produktet e gjakut, ose lëngjet e trupit, ose sende të mpiksura nga gjaku i thatë
<b>Mjetet e Mprehta Mjekësore</b>	Mjetet e mprehta mjekësore përfshijnë shiringat, pincetat, tehet e bisturive, provëzat dhe gjilpërat; mjetet prej qelqi të thyera ose jo
<b>Mbeturina Kafshësh</b>	Materiale të papërdorshme, midis tyre kafshë të ngordhura, pjesë të trupit, lëngje të trupit, gjak ose veshje shtretërish të ekspozuara ndaj substancave infektive
<b>Mbeturinat Izoluese me gjak,</b>	Materiale të papërdorshme të kontaminuara sekrecione, etj. të qenieve humane të izoluar për mbrojtjen e të tjerëve nga sëmundje të transm.
<b>Pajisje Mjekësore të Kontaminuara</b>	Pajisje mjekësore, që kanë qenë në kontakt me substance infektive
<b>Mbeturina Kirurgjikale</b>	Materiale të papërdorshme, midis tyre uniformat e ndotura, tamponë, pëlhura, rrobat, doreza, etj.
<b>Mbeturinat Laboratorike</b>	Mbeturina, që kanë qenë në kontakt me substancë infektive, psh. pjatat e mikroskopëve, mbuluesit e qelqtë.
<b>Mbeturina Dializë</b>	Efluentë dhe pajisje, që kanë qenë në kontakt me gjakun e pacienteve që i nenshtrohen dializes.

## Mbeturina farmaceutike

Shumë mbetje farmaceutike paraqesin një kërcenim për njerézit dhe mjedisin për shkak të përbërjes së tyre, bioakumulimit dhe tokositetit. Prandaj, do të ishte ideale që farmaceutikët e vjetëruar të kthehen tek shpërndarësit e tyre për një asgjësim të përshtatshëm. Për më tepër problemi i barnave të vjetruara, mund të zgjidhet duke zbatuar në mënyrë të vazhdueshme teknikat e nevojshme. Një inventar i reduktuar ndihmon gjithashtu në uljen e probabilitetit të barnave të skaduara, si dhe ofrimin e tyre në sasinë e duhur.

## PËRSHKRIMI I PROÇESEVE TË PUNËS

Spitali i Kolonjes ofron Menaxhimin e mbetjeve spitalore e cila konsiston në shërbimin e :

- regjistrimin e mbetjeve spitalore;
- grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore;
- ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;
- ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;

### Regjistrimi

Çdo prodhues i mbetjeve spitalore (pavionet e repartet) duhet të vendosë numrin e regjistrimit mbi të gjitha fletët shoqëruese, etiketat e vendosura në ambalazhimet që mbajnë mbetje spitalore dhe skedat bashkëngjitur ngarkesave që përbajnjë mbetje spitalore.

Numri i regjistrimit është individual dhe nuk mund të transferohet.

Fjala sinjalizuese:	RREZIK
Signalword:	DANGER
Shprehja e rrezikshmërisë:	mund te shkaktoje infekzion
Hazard Statement:	may cause infection
Nr. i UNi / UN -Number:	3291
Klasa / Class:	6.2
Katalogu i Mbetjeve:	18.01.03*
Waste Catalogue:	
Nr. i EINECSi / EINECS Nr.:	
R - Frasa / R - Phrase:	R21
S - Frasa / S - Phrase:	SI/4/24/35/36/37/43^/60
Shprehja parandaluese / Precautionary Statement:	
Identiteti i furnizuesit / Supplier Identification:	
Personi i Kontaktit / Contact Person:	
Adresa / Address:	
Numri i Telefonit / Tel Number:	

### Transportimi i mbetjeve spitalore infektuese

Ky transport i mbetjeve spitalore behet nga subjekti MEDI - TEL Shpk i kontraktuar nga spitali Kolonje. Automjeti që transporton mbetje spitalore infektuese është i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore .



Automjeti i përdorur për transportin e mbetjeve spitalore infektuese përfshinë një pjesë ngarkues-transportues, që rri e mbyllur për të parandaluar hyrjen dhe ekspozimin e paautorizuar ndaj erës dhe reshjeve;

- Nuk lejon derdhjet;
- Pastrimin dhe dizinfektimin pas rrjedhjeve ose derdhjeve aksidentale;
- Nuk përdoren për të transportuar ushqime, produkte ushqimore;
- Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore infektuese, automjetet mbajnë më vete një kit për ndalimin e derdhjeve dhe për pastrimin e automjetit.

### Trajtimi i mbetjeve spitalore

Çdo prodhues i mbetjeve spitalore

- Eshtë përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre.
- Ndan që në burim elementet e rrezikshme nga ato të parrezikshme të mbetjeve spitalore,
- Magazinon ato të ndara.

Pas procesit të ndarjes, për mbetjet spitalore të parrezikshme që cilësohen si "mbetje urbane" zbatohet ligji nr.8094, datë 21.3.1996 "Për largimin publik të mbeturinave".

Mbetjet spitalore të rrezikshme ambalazhohen dhe etiketohen dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.

Kur mbetjet spitalore duhet të transportohen për t'u trajtuar në vend tjetër, magazinimi në terren i tyre bëhet në një zonë të caktuar në brendësi apo në afërsi të vendeve të trajtimit, apo të pikave të nisjes, duke përbushur kërkesat e mëposhtme:

- Tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, parandalohen rrjedhjet, sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmanget kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre.

- Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallese tjetër të magazinuara për më shumë se 24 orë, ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.

Sistemet e kullimit të dyshemesë së magazinës mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", ose në një impiant grumbullimi që parandalon derdhjen e lëngjeve dhe rënien në kontakt me mjedisin.

Kontejnerët e mbetjeve të rrezikshme spitalore përbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, dhe etiketohen me simbolin:



Mbetjet spitalore nuk presohen apo nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike, dhe transportohen nga subjekti i kontraktuar brenda 45 ditësh nga grumbullimi i tyre.

### **Magazinimi i mbetjeve spitalore**

Mbetjet infektive nuk magazinohen për më shumë se 45 ditë para trajtimit. Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje mjekësore ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Zonat e magazinimit kanë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe parandalohet krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të rrethuara.

**Përpunimi dhe asgjësimi** i mbetjeve spitalore kryhet me metodat sipas:

- Incenerim
- Autoklavim:
  - Presion,
  - Presion - avull
  - Presion - avull - copëtim.
- Sterilizim me mikrovalë
- Sterilizim - UV
- Trajtim kimik/dizinfektim:
  - me shkumës të kloruar;
  - me klor aktiv (klor të lirë);

Implanti për trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve spitalore nuk duhet të pranojë nga prodhuesit mbetje spitalore në rast se nuk janë shoqëruar me fletë-dorëzimi, në përputhje me ligjin nr.9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme". Implanti duhet të mbajë regjistre të pranimeve, që minimalisht përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën e prodhuesit;
- peshën e mbetjeve të pranuara;
- datën dhe orën e pranimit të mbetjeve; dhe

- d) nënshkrimin e personit që pranon mbetjet.

Ne spitalin e Kolonjes nuk behet asgjesim i mbetjeve spitalore, me mundesite teknike, financiare e organizative qe kane tani per tani ne dispozicion. Prandaj eshte lidhur kontrate me subjektin EUROTEAM shpk per transferimin e mbetjeve te rrezikshme, per tu asgjesuar ne impiantin e tyre ne Tirane.

## **ADMINISTRIMI AKTUAL I MBETJEVE SPITALORE**

### **Përbërja e mbetjeve spitalore**

Në Spitalin e Kolonjes grumbullohen mbetje familjare, të cilat meren rregullisht nga Bashkia në bazë të kontratës së lidhur nga palët. Ka tre kazan të mëdhenj që meren çdo ditë nga operatori i kontraktuar me Bashkine. Këto mbetje përbëhen nga amballazhe të ndryshme, kartona, letra përdorimi, qese plastike, mbetje nga kancelaritë dhe rroba.

Për sa i përket mbetjeve spitalore ka pike grumbullimi ne spital të këtyre mbetjeve brenda standardeve, dhe procesi i transportit dhe trajtimit të tyre bëhet nga një kompani e specializuar në këtë fushë dhe e kontraktuar me Drejtoren e spitalit.

**Mbetje të rrezikshme** përbëhen nga placentat, anatomiqët, shiringa, age, aparate, etj. Ato mbahen në enë të mbyllura plastike të zëvendësueshem dhe në frigoriferë, të cilat trajtohen nga operatori përkatës. Në një muaj ka rreth 1100 kg mbetje, nga të cilat 50kg deri në 120kg janë mbetje të rrezikshme, pjesa tjetër janë mbetje jo të rrezikshme. Aktiviteti i menaxhimit të mbetjeve spitalore që kryen Spitali i Kolonjes është paraqitur në skemën e mëposhtme

### **Procesi i menaxhimit të mbeturinave spitalore**

- Ndarja** – mbeturinat spitalore ndahen fillimisht nga mbeturinat e tjera të zakonshme (komunale) në vendin e gjenerimit të tyre dhe pastaj ndahen edhe nga njëra -tjetra. Pasi ndahen në bazë të veticë të tyre, ato vendosen në kontejnerë të ndarë sipas ngjyrave: të kuqe, verdhë, gjelbër dhe të zezë, varësisht sipas llojit. Ndarja e tyre sipas veticë bëhet për arsy se disa lloje të mbeturinave duhet të trajtohen në mënyra të ndryshme dhe të përshtatshme.



*Foto . Kosha mbeturinash spitalore të vendosura në korridore të spitalit te Kolonje*

**2. Mbledhja** – mbeturinat mblidhen nga vendi ku është bërë ndarja e tyre dhe pastaj vendosen në vende të përkohshme magazinimi, duke përdorur rroba mbrojtëse dhe mjete transportuese të përshtatshme (karroca). Këto mjete përdoren vetëm për qëllim të transportit të mbeturinave.

**3. Magazinimi i mbeturinave** bëhet në vende të posaçme që i plotësojnë kushtet për magazinim të tyre, të cilat janë të mbyllura, ku nuk ka qasje askush, përveç personit të autorizuar. Per mbetjet trupore si placentat, pjese nga amputimet etj ruhen e frigoriferin e maternitetit, pjese perberese e spitalit Kolonje.

**4. Transportimi mbeturinave** nga vendet ku janë magazinuar deri në trajtimin përfundimtar asgjësimin, bëhet me mjete të cilat i plotësojnë kriteret mbi qarkullimin rrugor, kushtet higjenike, shëndetësore dhe mjedisore nga subjekti i kontraktuar.

#### **Karakteristikat e objektit**

- Objekti në studim është spital, që ka nevojë për menaxhim të integruar të mbetjeve spitalore;
- Objekti është i ekspozuar dhe i vendosur në relief me pjerrësi rreth  $11^0$ - $12^0$ , në pjesën kryesore të zonës, në tokë truall, brenda vijes se verdhe te qytetit.
- Energjia elektrike ndodhet afër objektit.
- Furnizimin i mjaftueshëm me ujë;
- Ventilim i përshtatshëm dhe izolimin e dhomave dhe hapësirat me rrezik të lartë të tilla si sallat e operacionit, njësitë e transplantit, zonat e kujdesit intensiv etj.

#### **Faktoret per perzgjedhjen e një teknologji jane:**

- Kapaciteti prodhues i mbetjeve
- Llojet e mbeturinave të trajtuar
- Efikasiteti i pasiviteti mikrobal
- Emisionet e mjedisit dhe mbeturina radikale
- Njohja e rregullores
- Kërkesat për sipërfaqe
- Shërbimet komunale dhe kërkesa të tjera të instalimit
- Reduktimi i volumit dhe i masës së mbeturinave
- Mbrojtja dhe shëndeti i punonjësve
- Zhurma dhe era e rëndë
- Automatizimi
- Saktësia
- Niveli i komercializimit

- Kosto
- Njohja nga stafi dhe komuniteti

### **Kapaciteti Prodhues**

Duke përcaktuar raportin e gjenerimit të mbeturinave për lloje të ndryshëm mbeturinash dhe duke integruar një plan rigoroz për minimizimin e mbeturinave, objekti i kujdesit shëndetësor gjendet tashmë në një pozicion për të përzgjedhur një teknologji trajtimi mos-djegie, raportet efiçente të së cilës janë të përshtatshme për llojet dhe sasitë e mbeturinave mjekësorë, që do të trajtohen.

Duke koordinuar kapacitetet e prodhimit (rendimentin) në raport me normën e gjenerimit të mbeturinave, objekti duhet të marrë në konsideratë rritjen e mundshme të përshpejtuar dhe variabilitetet në gjenerimin e mbeturinave. Disa teknologji mund të kenë një normë minimale furnizimi, për të mirë-operuar ose për të operuar me kosto të favorshme; teknologjitet kanë një normë maksimale furnizimi të përcaktuar.

Duke pare sasine e mbetjeve te rrezikshme qe gjenerohen ne spitalin e Kolonjes, u vu re se sasia vjetore prej 1300 kg e kontraktuar me subjektin MEDI - TEL shpk Tirane, ishte shume me pak se sasia e mbetjeve qe gjenerohen ne fakt. Prandaj Drejtoria e spitalit duhet te mendoje per nje sasi shtese per vitin 2016.

Njësitë mjekësore duhet të përcaktojnë nëse niveli i ndryshueshmërisë së gjenerimit të mbeturinave vendoset gjatë jetës së parashikuar të aparaturës brenda minimumit dhe maksimumit të normës së furnizimit të kësaj pajisje. Objekti po ashtu duhet të shqyrtojë mundësinë për të përdorur një kombinim të teknologjive.

### **Llojet e Mbeturinave të Trajtuara**

Pas ndarjes në kontenitorin e mbetjes, sigurohet, që teknologja e zgjedhur trajton çdo kategori të mbeturinave, të shkatërrimit mekanik, pasivitetit mikrobial, emisioneve, pranueshmërisë rregullatore, dhe sigurisë, duke marrë masa për mbeturinat e veçuara, kostot e trajtimit illogaritet kur krahasohen kostot e përgjithshme sipas alternativave.

### III. MENAXHIMI I INSTALIMIT

#### Plani i organizimit të ambientit

Në këtë aktivitet zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit teknik, që mendohet se ka ndikimet më të mëdha jo vetëm nga pikëpamja e efekteve momentale, por edhe për jetëgjatësinë e saj, e cila organizohet si më poshtë:

- Para së gjithash me marjen në dorëzim të të gjithë dokumentacionit teknike administrative, struktura merr të gjitha masat e organizimit, në drejtim të plotësimit me rigorozitet të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë. Para fillimit të punës duhet të kontrollohen gjendja e paisjejeve dhe e magazinës.
- Gjatë kryerjes së aktivitetit zbatohen me përpikmëri rregullorja e sigurimit teknik.
- Punonjësit pajisen me veshje pune dhe trajnohen në shërbimin e këtij aktiviteti. Duhet të disponohen dokumenta, ku pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, e cila do të bëhet e përvjavshme dhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.
- Duke u nisur nga problematikat që paraqesin këto produkte, del detyrë parësore zgjedhja e personelit të trajnuar në këto lloj shërbimesh që do të punojnë në këtë aktivitet.

#### Asgjesimi i mbetjeve spitalore

##### MBETURINAT QË DUHEN DJEGUR:

- Pjesët anatomike dhe kufomat e kafshëve;
- Droga citotoksiqe (të mbetur ose të skaduara)
- Kimikatet toksiko e laboratorike të tjera veç mërkurit
- Mbejtjet jo-plastike dhe jo-klorinik e plastike të krijuara nga pacientët;

##### MBETJET QË NUK MUND TË DIGJEN:

- Plastikat klorinike;
- Mbetjet toksike të paqëndrueshme, të tilla si mërkuri;



**Plastikat, jo plastikat e kontaminuara me gjak,** lëngje të trupave, sekrecionet dhe ekskrecionet si dhe mbetjet e laboratoreve infektive. (Mbetje të tilla duhet të trajtohen perms sterilizimit nëqese autoclave ose trajtimit me mikrovalë. Copëtimi mund të kryhet permes këtyre dy metodave. Në rast se asnjë nga metodat nuk është efektive, rekomandohet trajtimi kimik me 1% hipoklor ose një disifektanti ngjashëm. Megjithatë, përdorimi i tepruar i disifektantëve kimikë duhet të shmanget sa më shumë, sepse ai përbën rrezik për shëndetin . Mbetjet radioactive (duhet të përdoren në përputhje me ligjet vendase).

Çdo institucion shëndetësor duhet të organizojë, kryejë dhe të monitorojë aktivitetet në drejtim të menaxhimit efektiv të mbeturinave. Kjo nënkupton ndarjen e mbeturinave nga mbeturinat e zakonshme në vendin e gjenerimit të tyre dhe grumbullimin, magazinimin, trajtimin/asgjësimin e tyre.

Menaxhimi i mbeturinave nënkupton aktivitete te bazuara në këto parime:

- Strukturë dhe hierarki të qartë të përgjegjësive,
- Planifikim dhe organizim të kujdeshëm të aktiviteteve
- Trajnim të vazhdueshëm të të gjithë punonjësve

Gjenerimi i mbeturinave varet nga numri i pacientëve të trajtuar dhe llojet e shërbimeve të ofruar.

Përkruani kushtet e punës, siç tregohet në tabelën në vijim:

KUSHTET E PUNËS						
Numri total i punonjësve	6					
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA	
	2	5	1	1	2	
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / administrata		Instalimet			
Orët e punës	Zyrat / administrata		Instalimet			
	8 ore					
Numri i ditëve të punës në vit	250 dit pune/ punetor					
Numri i orëve në vit	2000					
Variacionet sezonale	Nuk ka					
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë variaçioneve sezonale		Pjesa tjeter e vitit			
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllët	Pushimet		Kryesisht ne muajin Gusht			
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit		Nuk ka nderpreje gjate vitit			

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashakëngiten këtij formulari me emërtimin Aneksi 3.

#### **IV. Lëndët e para dhe Materialet ndihmëse, materiale të tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar në impiant/Instalim**

**Tabela 4.1.1** Detaje mbi lëndët e para, materialet e ndërmjetme, produktet etj, që lidhen me proceset dhe përdoren apo gjenerohen në impiant/instalim.

Nr. Ref. ose Kodi	Materiali/ Substanca <sup>7</sup>	Numri CAS <sup>8</sup>	Kategoria e Materialeve të Rezikshme <sup>9</sup>	Sasia që zakonisht magazinohet (t)	Përdorimi vjetor(t)	Konsumi përnjësi produkti	Natyra e përdorimit	Kodi i Riskut R <sup>10</sup> -	Kodi i Sigurisë S <sup>11</sup> -
	Mbetje spitalore		1.3	100/200 t			Menaxhim - Transferim		

<sup>7</sup> Nëse materialet përfshijnë më shumë substanca të rrezikshme, jepni informacion të detajuar për seicilën substancë

<sup>8</sup> Shërbim i Abstrakteve Kimike (CAS - Chemical Abstracts Service)

<sup>9</sup> (Rregullore Nr. 1272/2008 (KE) për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve) ose kategoria e Mbetjeve/Materialeve të Rrezikshmeve sipas Rregullores për Kategoritë e Mbetjeve duke përfshirë listën sipas legjisacionit perkates shqiptar mbi mbetjet

<sup>10</sup> Sipas Aneksit 2 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

**Tabela 4.1.2** Detaje mbi konsumin e ujit:

INPUTI - UJËRAT HYRËSE									
Furnizimi me ujë nga rrjeti publik		Sigurimi i ujit nga burime sipërfaqësore		Sigurimi i ujit nga burime vetiake		Sigurimi i ujit nga reshjet e mbledhura		Sigurimi i ujit nga riciklimi i brendshëm	
Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%
200	100	0	0	0	0	0	0	0	0

**TRAJTIMI I MËPARSHËM** (jepni sasinë e ujit të trajtuar më parë me qëllim përmirësimin e cilësisë para përdorimit të tij brenda procesit)

PIKAT E KONSUMIT TË UJIT											
Tualetet/Banjat		Proceset e prodhimit		Prodhimi i energjisë/avullit		Ujë Ftohës		Pastrimi industrial		Pastrime të tjera	
Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%	Konsumi	%

OUTPUTI - UJËRAT QË DALIN		
Pjesë integrale e produktit, nga produktet, mbetjet	Shkarkimet (nga pajisjet vetiake të trajtimit/kanalizimeve)	Evaporimi (shkarkimi i avullit në ajër)

KOSTOT E UJIT			
EMËRTIMI	BAZA (m <sup>3</sup> /year)	KM/m3*	TOTALI
Kostot e Ujit			
TOTALI			

\* Kostot e ujit: sasia e konsumuar + tarifën fiksë.

**Tabela 4.1.3** Detaje mbi Konsumin e Energjisë

KONSUMI I ENERGJISË			
Burimi	Konsumi Total (kWH/g, t/g, dhe të ngjashme)	Konsumi për njësi prodhimi	Përqindja e konsumit total (%)
Energjia Elektrike	180 kw vetem per ndricim		
Gazi Natyror	200 litra/muaj per ngrohje		
Qymyri	0		
Të tjera	0		

## V.MENAXHIMI I MATERIALEVE

### MENAXHIMI I LËNDËVE TË PARA, MATERIALEVE TË NDËRMJETME DHE PRODUKTEVE

#### A. Informacion i detajuar mbi kushtet që kanë të bëjnë me dorëzimin dhe marrjen e tyre,

Institucionet shëndetësore gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore, krijojnë mbeturina medicinale të cilat janë të një forme të veçantë dhe paraqesin burim potencial të rrezikut për shëndetin publik dhe mjedisin. Me qëllim që të minimizohet ndikimi, këto mbeturina duhet të menaxhohen me kujdes të veçantë që nga vendi i krijimit të tyre, deri te trajtimi përfundimtar –asgjësimi. Grupi i punes në këtë vleresim ka ekzaminuar nëse mbeturinat nga institucionet shëndetësore janë menaxhuar siç duhet, me qëllim që të mos kërcënohet shëndeti publik dhe të ndotet mjedisit.

Kjo është bërë në të gjitha fazat e procesit të menaxhimit të mbeturinave, që nga krijimi, ndarja, mbledhja, magazinimi, transportimi dhe trajtimi– asgjësimi final i tyre, si dhe në nivelin e mbikëqyrjes së këtij procesi. Ky raport i identifikon mangësitë në trajimin e mbeturinave që lidhen me procesin e menaxhimit të integruar te mbeturinave spitalore dhe ofron rekomandime për përmirësimin e tërë procesit të menaxhimit.

Entiteti institucional i administrimit të mbetjeve spitalore është: **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kolonje.**

Bazuar në LIGJI Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE", Ku specifikohet në Neni 53 Kërkesa për leje mjedisi, Personat fizikë a juridikë, që synojnë të kryejnë operacione për trajimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisi në përputhje me ligjin ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", si dhe në VENDIM Nr.798, datë 29.9.2010 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE", funksionon sistemi menaxhues shqiptar i administrimit të mbetjeve spitalore. Vleresimi ynë është fokusuar në ekzaminimin e praktikave të përcaktuara në rregulloren e Administrimit të mbetjeve spitalore në institucionet publike shëndetësore, ku percaktohen trajtimi i mbetjeve spitalore sipas renditjes që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre.

Detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore janë si më poshtë:

- Çdo prodhues ndan që në burim elementet e rrezikshme nga ato të parrezikshme të mbetjeve spitalore, sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore dhe i magazinon ato të ndara.

- Pas procesit të ndarjes, për mbetjet spitalore të parrezikshme që cilësohen si "mbetje urbane" nenit 2 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor te mbetjeve të ngurta", zbatohet ligji nr.8094, datë 21.3.1996 "Për largimin publik të mbeturinave".
- Mbetjet spitalore të rrezikshme ambalazhohen dhe etiketohen në përputhje me standartin dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.
- Kur mbetjet spitalore duhet të transportohen për t'u trajtuar në vend tjetër, magazinimi në terren i tyre bëhet në një zonë të caktuar në brendësi apo në afërsi të vendeve të trajtimit, duke përmbrushur kërkesat e mëposhtme:
- Të tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre. Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallese tjetër të magazinuara për më shumë se 24 orë, por gjithsesi më pak se 48 orë nga ambalazhimi, duhet të ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.
- Të jenë ndërtuar me materiale të qëndrueshme dhe pa kënde, që pastrohen lehtësisht, që nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve dhe të jenë rezistentë ndaj parazitëve e agjentëve të tjerë mjedisorë.
- Të mbahen pastër në kushte të mira sanitare dhe në gjendje të mirë funksionale.
- Mbetjet të jenë të etiketuara në mënyrë të dukshme me simbolin ndërkontëtar të biorrezikshmërisë dhe me njoftime të rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, frigoriferë dhe kontejnerë të tjerë që tregojnë përdorimin e magazinës për mbetje spitalore, ku hyrja e personave të paautorizuar është e ndaluar.
- Sistemet e kullimit të dyshemesë së magazinës duhet të mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", ose në një impiant grumbullimi që parandalon derdhjen e lëngjeve dhe rënien në kontakt me mjedisin.
- Kontejnerët e mbetjeve të rrezikshme spitalore duhet të përmbrushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të etiketohen dhe të magazinohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen për qëllime inspektimi.
- Mbetjet spitalore nuk duhet të presohen apo t'u nënshtronen veprimeve të sforcuara mekanike, përvèç rasteve kur këto janë pjesë e një procesi të posaçëm trajtimi, të miratuar nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, bazuar në ligjin

nr.9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme". Mbetjet e rrezikshme spitalore transportohen brenda 45 ditësh nga grumbullimi i tyre.

- Transportimi në terren i mbetjeve të rrezikshme spitalore kryhet në përputhje me:
  - Mbetjet spitalore që krijohen jashtë zonës se prodhimit fillestare të tyre, nuk pranohen për transport në terren.
  - Asnjë person nuk duhet të pranojë për transport mbetjet spitalore që nuk janë ambalazuar dhe etiketuar në përputhje me standartin.
- Magazinimi i mbetjeve spitalore. Mbetjet infektive nuk duhet të magazinohen për më shumë se 45 ditë para trajtimit. Në qoftë se era përbën shqetësim publik, Inspektorati Sanitar Shtetëror/Inspektorati i Mjedisit kërkon largim më të shpeshtë. Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje mjekësore duhet të ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Zonat e magazinimit duhet të kenë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk duhet të lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe të parandalohet krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të janë të rrethuara.
- Impiantet për përpunimin e mbetjeve spitalore duhet të respektojnë kushtet e asgjësimit dhe normat e shkarkimeve në ajër të përcaktuara në pikën 5.1.2 "Linja për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, date 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.

Kujdesi shëndetësor publik në vendin tone organizohet dhe zbatohet në tre nivele: primar, sekondar dhe tertiar.

Institucionet e kujdesit shëndetësor të nivelit primar janë Qendrat kryesore të Mjekësisë Familjare me njësítë përbërëse, ku Bashkite janë entitetet kyçë për këtë nivel të kujdesit shëndetësor publik. Ndërsa, Ministria e Shendetësise është përgjegjëse për dy nivelet e tjera të kujdesit shëndetësor.

Kujdesi shëndetësor sekondar përfshinë: shërbimet spitalore dhe jashtë- spitalore, shërbimet diagnostike, terapeutike, rehabilituese dhe transportin emergjent. Kujdesi shëndetësor tertiar organizohet dhe ofrohet në institucione, ku krahas veprimtarisë shëndetësore ofrohet edhe shkollimi universitar, shkollimi specialistik dhe sub-specialistik, si dhe puna kërkimore- shkencore. Me qëllim të vlerësimit nëse praktikat e menaxhimit të mbeturinave janë efikase dhe efektive, ne kemi analizuar këtë entitet – Sherbimi Spitalor Kolonje;

**Tabela 5.2.1:** Mbetjet – Rikuperimi/asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme

Tipi i mbetjes	Numri nga Rregullorja pér Kategoritë e Mbetjeve, duke përfshirë listat	Vendi kryesor i gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjesimi në instalim/impiant (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi ose riciklimi jashtë instalimit/impiantit (Metoda, vendi, kontraktori)	Asgjesimi/trajtimi jashtë instalimit/impiantit (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/muaj	m <sup>3</sup> / muaj			
Mbetje spitalore		Spitali Kolonje	Deri ne 0.12 ton ne muaj			Trajtimi i mbetjeve spitalore nga MEDI - TEL shpk	

**Tabela 5.2.2 Mbetjet – Rikuperimi/asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme**

Tipi i mbetjes	Numri nga Rregullorja për Kategoritë e Mbetjeve, duke përfshirë listat	Vendi kryesor i gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjësimi në instalim/impian t (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi ose riciklimi jashtë instalimit/impian tit (Metoda, vendi, kontraktori)	Asgjësimi/trajti mi jashtë instalimit/impian tit (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/muaj	m <sup>3</sup> /muaj			
Mbetje urbane			12 ton		-	-	Subjekt i kontraktuar nga Bashkia, mbetjet groposen ne landfillin provizor

### **5.1 ASGJESIMI I MBETJEVE JASHTË INSTALIMIT**

Në rast të asgjësimit të mbetjeve jashtë territorit të instalimit/impiantit, është e nevojshme të siguroni një informacion të detajuar mbi vendin e asgjësimit si dhe të bashkëngjisni kontratat e lidhura me kompanitë/operatorët, të cilët kryejnë shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të të gjitha llojeve të mbetjeve.

**Asgjesimi i mbetjeve spitalore te rrezikshme behet nga Kontraktori MEDI - TEL Shpk, jashte ambienteve te spitalit Kolonje. Ndersa mbetjet urbane (mbetjet jot e rrezikshme) grumbullohen ne konteniere 1.1 m<sup>3</sup> dhe largohen cdo dite nga subjekti i kontraktuar nga Bashkia Kolonje, per ne landfillin provizor, 2 km larg.**

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 5**.

## VI. SHKARKIMET

### 5.2 SHKARKIMET NË AJËR

#### 6.1.1 INFORMACION I DETAJUAR PËR SHKARKIMET NGA BURIMET E IDENTIFIKUESHME TË NDOTJES NË AJËR - NUK KA SHKARKIME

Operatori duhet të paraqesë një listë të gjithë burimeve të shkarkimeve në ajër. Planimetritë, skicat dhe dokumentat përkatëse që tregojnë vendndodhjen e pikës së shkarkimit (kopje të planimetrisë së përfshirë në projektin e instalimit) duhet të përfshihen gjithashtu në informacion. Të gjithë informacionet e kërkova më sipër duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 6**.

### 5.3 SHKARKIMET E MUNDSHME DHE FLURUESE - NUK KA SHKARKIME

Për të gjitha burimet e mundshme dhe ato fluruese (të shkarkimeve, duhet të plotësohet tabela 6.2.1, si dhe të sigurohet një informacion i detajuar mbi to.

Në përputhje me aktivitetet e renditura referuar kuadrit ligjor shqiptar për shkarkimet e komponimeve organike të avullueshme, tregoni nëse shkarkimet janë të përputhje me dispozitat ligjore në fuqi ose jo dhe, nëse jo, shpjegoni se si do të arrini këtë përputhshmëri. Plani i menaxhimit të tretësve organikë duhet të jetë bashkëngjitur kërkosës.

### 5.4 SHKARKIMET NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË – NUK KA SHKARKIM

Për shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë duhet të plotësohen Tabelat 6.3.1 dhe 6.3.2.

Rendisni të gjitha pikat e shkarkimit shoqëruar me planimetritë, skicat dhe dokumentat përkatëse, bashkëngjitur këtij formulari si Aneksi 6.

Për secilën pikë shkarkimi, është e nevojshme të tregoni substancat që shkarkohen. Duhet të llogariten të gjithë llojet e shkarkimeve të lëngshme dhe llumrat në ujërat sipërfaqësorë si dhe rreshjet atmosferike që për shkak të forcës së gravitetit shkojnë drejt ujërave sipërfaqësore. Pikat shkarkimit duhet të tregohen në hartën e terrenit me koordinata të shënuara në sistemin GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4. Duhet të specifikohet gjithashtu edhe identiteti dhe tipi i mjedisit ujor pritës.

### 5.5 SHKARKIMET NË RRJETIN E KANALIZIMEVE NUK KA

Për shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve duhet të plotësohen Tabelat 6.4.1 and 6.4.2. Paraqisni të gjitha pikat e shkarkimeve përmes planimetrike, skicave dhe dokumentave përkatës, të përfshira në **Aneksin 6**.

Për secilën pikë shkarkimi, është e nevojshme të tregoni substancat që shkarkohen.

**Aneksi 6** duhet të paraqesë të gjithë informacionin përkatës mbi kanalin-marrës, duke përfshirë edhe sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk janë përshkruar më parë.

Jepni informacion të detajuar mbi të gjitha shkarkimet që mund të ndikojnë në tërësinë e rrjetit të kanalizimeve dhe sigurinë e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së tij.

## 5.6 SHKARKIMET NË TOKË NUK KA

Për shkarkimet në tokë duhet të plotësohen Tabelat 6.5.1 dhe 6.5.2.

Përshkruani sistemet dhe procedurat për të parandaluar ose reduktuar çlirimet e ndotësve në mjediset e ujërave nëntokësorë, si dhe procedurat për parandalimin e ndikimeve negative në mjediset e ujërave nëntokësorë.

Kërkuesi duhet të japë informacion mbi llojet e substancave (mbetje bujqësore ose jo-bujqësore) që do të shpërndehen në tokë (mbetje llumrash, hi, mbetje të lëngshme, etj.) si dhe sasinë e propozuar, periudhat dhe metodën e shpërndarjes (tub i shkarkimit, rezervuar, cisternë).

Çdo pikë shkarkimi ose zonë shkarkimi duhet të tregohet në hartën e instalimit.

## 5.7 SHKARKIMET E ZHURMËS

Jepni informacion të detajuar mbi burimet (vendndodhjen, natyrën, nivelin, periudhën ose periudhat e shkarkimit) e zhurmës që është gjeneruar ose do të gjenerohet.

Tabela 6.6.1 duhet të përbajë informacion për secilin burim shkarkimi. Çdo burim shkarkimi i zhurmës duhet të shënohet qartë në hartën e instalimit.

Dokumentacioni mbështetës duhet të përfshihet në **Aneksin 6**.

## 5.8 VIBRACIONET NUK KA

Duhet të përgatitet një informacion i detajuar për vibracionet, dhe nëse është e mundur, të paraqiten edhe informacionet që i përkasin vitit të kaluar.

Specifikoni dhe shënoni në hartë vendndodhjen e burimeve të vibracionit që mund të ndikojnë në mjedis, përtej ambienteve të instalimit dhe siguroni rezultatet e matjeve ose llogaritjeve.

Burimet e vibracionit duhet të përfshijnë edhe transportin që bëhet brenda instalimit. Për instalimet e reja, duhet të merren në konsideratë të gjitha burimet e vibracionit gjatë ndërtimit dhe operimit të instalimit. Të gjitha burimet duhet të përshkruhen në shtojcat grafike.

Të gjithë dokumentat shtesë që kanë lidhje me sa u përmend më sipër, duhet të përfshihen në **Aneksin 6**.

## 5.9 REZATIMI JO-JONIZUES NUK KA

Identifikoni burimet e rrezatimit jo-jonizues që kanë ndikim në mjedisin përtej ambienteve të instalimit dhe tregoni rezultatet e matjeve ose llogaritjeve të kryera për këtë qëllim. Burimet e rrezatimit duhet të tregohen qartë në hartën e instalimit.

## 5.10 PËRSHKRUAJ GJENDJEN E VENDNDODHJES

Jepni të dhëna për gjendjen e mjedisit (ajrin, ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, tokën, zhurmat, hidrologjinë, stabilitetin, speciet e mbrojtura etj.) që kanë lidhje me ndërtimin dhe vënien në punë të instalimit.

Bëni të njohur vlerësimin e ndikimit të gjithë shkarkimeve në mjedis, përfshirë edhe vendet/mjediset ku shkarkimet nuk janë çliruar ende.

